



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Suharekë
Opština Suva Reka
Municipality Suharekë

16.04.2025

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E SUHAREKËS REPUBLIKA KOSOVA - OPŠTINA SUVA REKA REPUBLIC OF KOSOVA - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA			
MAPË NË DORËZIM-PRIMJENË-RECEIVED			
Njësia org. Org. Jedinica Org. Unit	Numri Org. Number	Classica Prilog Appendix	Vlera Vrednost Value
01	0/6	2249	f

STATUTI
I
KOMITETIT TË AUDITIMIT
NË KOMUNËN E SUHAREKËS

Suharekë, prill 2025

Në mbështetje të nenit 13 të ligjit për Vetëqeverisje Lokale, paragrafit 1 dhe 2 të nenit 20 të Ligjit Nr. 06/L-021 Për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike (Gazetën Zyrtare Nr.3/19 Prill 2018), dhe nenit 6 paragrafi 4 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2019, Për Themelimin dhe Funksionimin e Komitetit të Auditimit në Subjektin e Sektorit Publik, Komiteti i Auditimit i Komunës së Suharekës i themeluar me vendimin e kryetarit të Komunës, Nr. 01-Nr.400-36774 i datës 08.07.2024, nxjerr:

STATUTIN E KOMITETIT TË AUDITIMIT

KAPITULLI I- DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Me këtë Statut përcaktohet përbërja, pjesëmarrja në takime, shpeshtësinë e takimeve, autoriteti, detyrat dhe procedurat e raportimit dhe kompensimin e anëtarëve të Komitetit të Auditimit.

Neni 2

Fushëveprimi

Dispozitat e këtij Statuti zbatohen nga Komiteti i Auditimit i cili është organ i pavarur këshillëdhënës dhe mbështetës për menaxhmentin e lartë në Komunë e Suharekës, Njësin e Auditimit të Brendshëm, si dhe njësitë(drejtoritë, zyrat) e Komunës së Suharekës.

Neni 3

Themelimi i Komitetit të Auditimit

Çdo subjekt i sektorit publik që ka të themeluar Njësinë e Auditimit të Brendshëm në nivel të organit kryesor sipas legjislacionit në fuqi, themelon Komitetin e Auditimit.

KAPITULLI II- KOMITETI I AUDITIMIT

Neni 4

Përbërja dhe Mandati i Komitetit të Auditimit

1. Komitetit të Auditimit i themeluar me vendimin e kryetarit të Komunës, Nr. 01-Nr.400-36774 i datës 08.07.2024, përbëhet nga tre(3) anëtar, dy(2) nga të cilët janë të jashtëm dhe një(1) nga stafi i brendshëm i organizatës buxhetore.
2. Mandati i Komitetit të Auditimit është tre(3) vjeçar, me të drejtë të riemërimit, por jo më shumë se për dy (2) mandate të njëpasnjëshme.
3. Komiteti i Auditimit përgatit statutin i cili përfshinë përbërjen e Komitetit të Auditimit, pjesëmarrjen në takime, orarin, shpeshtësinë e takimeve, autoritetin, detyrat dhe procedurat e raportimit. Statutin nënshkruhet nga kryesuesi i Komitetit të Auditimit dhe aprovohet nga Kryetari i komunës.

Neni 5
Detyrat dhe Përgjegjësitë e Komitetit të Auditimit

1. Komiteti i Auditimit ka përgjegjësi si në vijim:

1.1 Këshillon Kryetarin e komunës për çështjet që kanë të bëjnë me:

- 1.1.1 Themelimin dhe zhvillimin e sistemit të përgjithshëm të kontrollit të brendshëm të financave publike;
- 1.1.2 vlerësimin e rrezikut;
- 1.1.3 menaxhimin e rrezikut; dhe
- 1.1.4 përshtatshmërinë e burimeve të aktiviteteve të auditimit për të realizuar me sukses planin e auditimit.

1.2 Siguron marrëdhënie efektive dhe bashkëpunuese ndërmjet Kryetarit të komunës, zyrtarit kryesor financiar, Njesisë së Auditimit të Brendshëm dhe auditorit të jashtëm;

1.3 Miraton statutin e auditimit të brendshëm;

1.4 Shqyrton dhe miraton planet strategjike dhe vjetore të auditimit të brendshëm, pa pasur kompetenca drejtuese për këto dokumente;

1.5 Mbikëqyrë dhe vlerëson performancën e aktivitetit të auditimit në përmbushjen e planit të miratuar, përmes raporteve periodike nga Drejtori/udhëheqësi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm;

1.6 Siguron që mashtrimet e mundshme të identifikuar nga raportet e auditimit të brendshëm ose të sjellë ndryshe në vëmendjen e Komitetit të Auditimit, të raportohen tek autoritetet kompetente;

1.7 Shqyrton raportet përmbledhëse, gjetjet, rekomandimet e auditimit të brendshëm dhe siguron që ato janë adresuar siç duhet nga Kryetari i komunës;

1.8 Shqyrton raportet e rregullta mbi statusin e zbatimit të planeve të veprimit të miratuara nga udhëheqësi që rezultojnë nga auditimet e mëparshme të brendshme dhe rekomandimet e auditimit të jashtëm;

1.9 Shqyrton pasqyrat financiare dhe opinionet e raporteve të auditimit të jashtëm;

1.10 Mbrojë pavarësinë funksionale të Auditorëve të Brendshëm;

1.11 Shqyrton raportin vjetor për aktivitetet e Njesisë së Auditimit të Brendshëm para se të dorëzohet në Njësine Qendrore Harmonizuese në Ministrinë e Financave.

Neni 6**Takimet e Komitetit të Auditimit**

1. Komiteti i Auditimit mbahen së paku katër (4) takime në vit, duke mbuluar periudhat tre mujore të vitit(TM1, TM2, TM3 dhe TM4).
2. Komiteti i Auditimit mban së paku një(1) takim për çdo tremujor të përfunduar të vitit. Takimet e Komitetit të Auditimit ftohen nga Kryesuesi.
3. Kryesuesi mund të thërras takime shtesë, sipas vlerësimit të tij apo anëtarëve të Komitetit të Auditimit.
4. Komiteti i Auditimit mund të mbaj mbledhje edhe me kërkesën e udhëheqësit të SSP të organizatës(Kryetari i Komunës) për të diskutuar çështjet të caktuara për të cilat kërkojnë këshilla nga Komiteti i Auditimit.
5. Kur është e nevojshme, Komiteti i Auditimit mund të ftojë edhe zyrtarët dhe personat tjerë që lidhen me auditimet e përfunduara, për të marrë pjesë në takimet e Komitetit të Auditimit. Zyrtari kryesor financiar dhe Drejtori/Udhëheqësi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm ofrojnë mbështetje për Komitetin e Auditimit, atëherë kur është e nevojshme dhe kur kërkohet nga Kryesuesi i Komitetit të Auditimit.
6. Drejtori/Udhëheqësi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm merr pjesë në takimet e Komitetit të Auditimit, me përjashtim kur Komiteti i Auditimit diskuton temat që ndërlidhen me performacën e Njesisë së Auditimit të Brendshëm të Komunës së Suharekës.
7. Takimi i Komitetit të Auditimit, mbahet kur janë të pranishëm në takim shumica e anëtarëve të komitetit.
8. Njësia e auditimit të brendshëm ofron shërbimet e sekretarisë për Komitetin e Auditimit. Procesverbalet mirëmbahen për një periudhë prej së paku 7 (shtatë) vjetësh në NjAB.

Neni 7**Bashkëpunimi me NjAB dhe palët tjera**

1. Komiteti i Auditimit dhe NjAB bashkëpunojnë në mënyrë reciproke. Komunikimi mes Komitetit dhe Njesisë së Auditimit të Brendshëm është i rëndësishëm dhe realizohet nëpërmjet:
Takimeve të Komitetit të Auditimit dhe Drejtorit/Udhëheqësit të NJAB-së;
Raporteve përmbledhëse periodike të veprimtarisë së auditimit të brendshëm;
Raportit vjetor për aktivitetet e auditimit.
2. Komiteti i Auditimit bashkëpunon me Kryetarin e komunës, zyrtarin kryesor financiar, auditorët e brendshëm dhe me Zyrën Kombëtare të Auditimit, lidhur me rishikimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të financave publike dhe rekomandimet e dhëna.
3. Komiteti i Auditimit ofron qasje të plotë dhe të papenguar të të gjitha të dhënat ose raportet e hartuara dhe të mirëmbajtura nga Komiteti i Auditimit, pas kërkesës së Zyrës Kombëtare të Auditimit ose autoriteteve të tjera publike të ngarkuara me funksione hetuese ose kontrolli.

4. Të gjitha programet buxhetore të organizata(drejtorit, njësitë, zyrat) obligohen që të bashkëpunojnë dhe ti ofrojnë mbështetje Komitetit të Auditimit, për realizimin e detyrave dhe përgjegjësi të tij.

Neni 8

Procedurat e raportimit dhe përgatitja e raporti vjetor të Komitetit të Auditimit

1. Pas çdo takimi të realizuar, Komiteti i Auditimit raporton tek udhëheqësi i subjektit të sektorit publik(Kryetari i Komunës) duke përmbledhur aktivitetet e ndërmarra dhe ofruar këshilla për veprimet e mëtejshme.;
2. Komiteti i Auditimit përgatitë raport vjetor për Kryetarin e komunës i cili përfshinë informatat për:
 - 2.1 Përbërja e Komitetit, detyrat dhe realizimi i tyre;
 - 2.2 Përshtatshmërinë e mjedisit të kontrollit të brendshme, për të siguruar funksionim efektiv, efikas dhe të ligjshëm;
 - 2.3 Përshtatshmërinë e sistemit të menaxhimit rrezikut dhe mënyrat e eliminimit të tyre;
 - 2.4 Pozitën financiare të Komunës, përshtatshmërinë e sistemit të menaxhimit financiar dhe raportimin e saj;
 - 2.5 Pavarësinë e auditorit dhe efektivitetin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm;
 - 2.6 Përshtatshmërinë e veprimeve të Kryetarit të komunës të ndërmarra për adresimin e rekomandimeve të Njesisë së Auditimit të Brendshëm dhe të Zyrës Kombëtare të Auditimit; dhe
 - 2.7 Përmbledhjen e punës së Komitetit të Auditimit.
3. Raporti vjetor i Komitetit të Auditimit i dorëzohet Kryetarit të komunës më së largu deri më 31 mars.
4. Raporti vjetor nga paragrafi 2 i këtij neni nuk do të përsërisë përmbajtjen e detajuar të raporteve të auditimit të brendshëm.

Neni 9

Kompensimi për punën e kryer (pagesat)

1. Pagesa e anëtarëve të Komitetit bëhet në bazë të legjislacionit në fuqi që e rregullon çështjen e Kompensimit për komisionet /bordet e institucioneve shtetërore të R. Kosovës

KAPITULLI I- DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 10

Dorëheqja e kryesuesit dhe anëtarëve të Komitetit të Auditimit

1. Kryesuesi dhe anëtarët e Komitetit të Auditimit mund të japin dorëheqje nga Komitetit i auditimit.
2. Kryesuesi Komitetit të Auditimit e njoftojnë Kryetarin e Komunës për dorëheqjen e ofruar.
3. Anëtarët e Komitetit të Auditimit e njoftojnë Kryetarin e Komunës dhe Kryesuesin e KA për dorëheqjen e ofruar.

4. Kryesuesi dhe anëtarët që japin dorëheqje duhet të kryejnë detyrat e tyre që lidhen me fushëveprimin deri në kohën e dhënies së dorëheqjes.

Neni 11

Shkarkimi i kryesuesit dhe anëtarëve të Komitetit të Auditimit

1. Kryetari me vendim mundë ti shkarkojë Kryesuesin dhe anëtarët e Komitetit të Auditimit, nëse:
 - 1.1 Kryesuesi apo anëtari i KA nuk ka treguar performancë të mirë;
 - 1.2 Është dënuar për veprë penale nga Gjykata Kompetente.
2. Komiteti i auditimit me shumicë votash mundë të kërkojë nga Kryetari që të shkarkojë secilin anëtar duke përfshi edhe kryesuesin e Komitetit të Auditimit, nëse:
 - 2.1 nuk i kryen detyrat që janë parapa me udhëzimin e KA;
 - 2.2 keqpërdor dhe/apo neglizhon pozitën si anëtar i KA.
3. Në raste të shkarkimit të anëtarëve të KA, Kryetari emëron anëtarin/ët e ri.

Neni 12

Dispozitat Përfundimtare

1. Procesverbalet e takimeve të Komitetit të Auditimit mbahen në pajtim me kërkesat e përcaktuara me legjislacionin në fuqi dhe detyrimisht në fund të saj, duhet të nënshkruhen nga Kryesuesi, anëtarët e KA dhe procesmbajtësi(ose në listën e pjesëmarrjes si shtojcë e procesverbalit të takimit të mbajtur).
2. Komiteti i Auditimit merr vendime me shumicën e votave që zotërojnë anëtarët e komitetit.
3. Për të gjitha çështjet që nuk janë të përcaktuara në këtë Statut do të zbatohen dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-021 Për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike (Gazeta Zyrtare Nr.3/19 Prill 2018) dhe legjislacionin në fuqi.

Neni 11

Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të këtij Statuti shfuqizohet Statuti i Komitetit të Auditimit të Komunës së Suharekës i datës 16.01.2021.

Neni 12

Hyrja në fuqi

Ky Statut hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryesuesi i KA dhe Kryetari i Komunës së Suharekës, nga:

Z. Agron Hoxha

Kryesuesi Komitetit të Auditimit

Z. Bali MUHARREMAJ

Kryetari i Komunës

